

STATUTI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
APIALB SHPK

Në datën e përcaktuar në fund të këtij dokumenti, ortaku i vetëm
Arbër Bajrami, i datelindjes 04-02-1987, me Nr. Personal ID I70204115C,
vendos miratimin e këtij Statuti për themelimin dhe rregullimin e veprimtarisë së shoqërisë, me termat
si më poshtë:

KREU I

Emri – Objekti – Selia – Kohëzgjatja

NENI 1

Emri dhe forma juridike

Emri tregtar është **APIALB shpk**

Është një person juridik shqiptar i organizuar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar që
operon në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin në regjistrin tregtar.

NENI 2

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt veprimtari tregtim import eksport te produkteve te bletarisë

NENI 3

Selia

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga Vellezerit Frasherit, ndertesa nr.60

NENI 4

Kohëzgjatja

Shoqëria themelohet ditën e nënshkrimit të këtij akt themelimi për një kohëzgjatje të pacaktuar.

KREU II

Kapitali i Shoqërisë

NENI 5

Kontributi i Ortakëve

Kapitali themeltar i shoqërisë është i-përbërë nga kontributi në para i ortakëve themelues të kësaj
Shoqëric prej **2.000,000 (dymiljon milion) lekë**.

NENI 6

Kapitali i shoqërisë

Kapitali është i përbërë nga 1 (një) kuotë.

Ortaku i vetëm **Arber Bajrami** zotëron një kuotë me vlerë nominale 2.000,000 (dymiljon milion) lekë e barabartë me 100 % të kapitalit.

Derdhja e kapitalit në vlerë monetarë ose në natyrë kryhet sipas marrëveshjes së posaçme të miratuar nga ortakët themelues.

NENI 7

Përgjegjësia e kufizuar e ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen kundrejt palëve të treta përtej kontributit të tyre.

NENI 8

Transferimi i kuotave

Në rast se ka më shumë se një ortak, ortakët e shoqërisë, në rastet e transferimit të kuotave, rezervojnë të drejtën e parablerjes së kuotave të shoqërisë.

Ortaku që dëshiron të shesë kuotën e tij duhet të njoftojë ortakët e tjera me shkrim për çmimin dhe modalitetet e pagesës. Brenda 30 ditëve nga njoftimi, ortakët e tjera duhet të njoftojnë me shkrim ortakun shitës nëse duan ta ushtrojnë të drejtën e parablerjes.

Kur afati 30 ditor kalon pa asnjë lajmërim nga ortakët, atëherë e drejta e parablerjes do të konsiderohet e ezauruar dhe ortaku është i lirë të shësë kuotën e tij kujtdo blerësi.

KREU III

Administrimi i Shoqërisë

NENI 9

Administratori i Shoqërisë

Shoqëria administrohet **Arbër Bajrami**, i datelindjes 04-02-1987, me Nr. Personal ID I70204115C, si administrator i vetëm i emëruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 10

Përfaqësimi i Shoqërisë

Administratori përfaqëson ligjërisht Shoqërinë me palët e treta. Nëse Shoqëria emëron më shume se një administrator, veprimet e tyre janë të vlefshme vetëm nëse nënshkruhen dhe miratohen nga të gjithë administratorët.

NENI 11

Kompetencat e administratorit

Administratori angazhon përgjegjësinë e tij kundrejt ortakëve në rast se kryen veprime që dalin përtej objektit të shoqërisë ose në rast se kryen veprime për të cilat nevojitet miratimi paraprak i Asamblesë së Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme miraton, nëse e sheh të arsyeshme, një akt të posaçëm ku parashikohen veprimet për të cilat nevojitet pëlqimi paraprak i Asamblesë së Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme vendos për të gjitha çështjet që tejkalojnë kompetencat e administratorit. Administratori, nën përgjegjësinë e tij, mund të asistohet nga kushdo person i zgjedhur prej tij dhe t'i delegojë atij/asaj disa prej kompetencave të tij për ushtrimin e funksioneve apo detyrave të caktuara.

NENI 12

Përgjegjësia e administratorit

Administratori është përgjegjës kundrejt shoqërisë apo palëve të treta qoftë për shkeljet e ligjeve që rregullojnë shoqëritë tregtare, qoftë për shkeljen e statutit apo për fajet e kryera në ushtrimin e detyrave të administrimit dhe menaxhimit të shoqërisë.

NENI 13

Shpërblimi i Administratorit

Administratori përfiton një shpërblim të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme. Të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në kontratën e shërbimit.

Në rast se administratori kryen detyra të tjera përvec administrimit të Shoqërisë, atëherë midis tyre mund të nënshkruhet një kontratë pune që rregullohet sipas Kodit të Punës.

NENI 14

Kontrolli i administrimit

Secili ortak ka të drejtë të njihet me të gjitha veprimtaritë e shoqërisë dhe t'i vihen në dispozicion, në vendin e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë, dokumentet dhe librat kontabël të shoqërisë.

NENI 15

Dorëheqja dhe shkarkimi

Administratori mund të japë dorëheqjen duke respektuar kushtet e përcaktuara në kontratën e shërbimit të lidhur midis tij dhe shoqërisë.

Administratori mund të shkarkohet në çdo çast nga Asambleja e Përgjithshme. Kjo dispozitë nuk cënon të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në kontratën e shërbimit apo në kontratën e punës.

KREU III

Ortakët

NENI 16

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është kompetente për marrjen e këtyre vendimeve:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

- përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- shpërndarjen e fitimit
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

NENI 17

Vendimmarrja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme merr vendime me tri të katërtat e votave për:

1. ndryshimet e statutit;
2. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
3. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

Për raste të tjera, për sa e lejon ligji, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

NENI 18

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Ortakët janë të detyruar t'i komunikojnë Administratorit adresën e tyre të banimit dhe adresën elektronike. Administratori i vë në dispozicion çdo ortaku listën përkatëse.

Njoftimi në adresën e komunikuar nga ortaku konsiderohet i vlefshëm.

Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga administratori dhe secili ortak. Administratori ose ortaku që thirret Asamblenë e Përgjithshme luan rolin e kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme dhe përgjigjet për rregullshmërinë e thirrjes, të votimit dhe të dokumentimit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 19

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme mblidhet sa herë që është e nevojshme për të përbushur detyrimet ligjore dhe për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

NENI 20

Proçesverbali i mbledhjes se asamblesë

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.

Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së Përgjithshme.

Procesverbalı duhet të përmbarajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Vota e ortakëve shprehet me shkrim në një dokument të posaçëm ose vërtetohet nëpërmjet letrës apo postës elektronike të dërguar nga ortaku.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së Përgjithshme.

Procesverbalı i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

NENI 21

Mënyra e votës

Ortakët mund të votojnë duke marrë pjesë personalisht apo nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar në Asamblenë e Përgjithshme.

Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhje përmes videokonferencës nëpërmjet mjeteve elektronike (si Zoom, Skype, Microsoft Teams, Gotomeeting etj.)

Ortakët mund të votojnë, gjithashtu, duke dërguar votën e tyre përmes një letre apo postës elektronike.

KREU IV

Shpërndarja e fitimeve dhe humbjeve

NENI 22

Bilanci dhe pasqyrat financiare

Brenda një muajji pas mbarimit vitit finanziar, administratori përgatit dhe i paraqet Asamblesë së Përgjithshme bilancin dhe pasqyrat financiare, si edhe raportin e ecurisë së veprimtarisë.

Brenda dy muajsh pas mbarimit vitit finanziar, Asambleja e Përgjithshme merr vendim pér miratimin e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.

Administratori është përgjegjës pér depozitimin e bilancit kontabël dhe dokumenteve të tjera pranë organeve shtetërore, si edhe pagimin e tatimit mbi fitimin brenda afateve ligjore.

ARTICLE 23

Destinimi i fitimit

Pas pagimit të tatimit mbi fitimin, brenda një afati prej 4 muajsh nga data e mbylljes së vitit finanziar, por gjithsesi jo më vonë se afatet e përcaktuara në ligj, Asambleja e Përgjithshme merr vendim mbi destinimin e fitimit.

Asambleja e Përgjithshme vendos, në prioritet, të miratojë rezerva pér investime të ardhshme apo pér qëllime të tjera. Fitimi i mbetur shpërndahet në formë dividendi pér ortakët. Në raste të veçanta, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë zmadhimin e kapitalit përmes fitimit të pashpërndarë.

Administratori është përgjegjës pér depozitimin e këtij vendimi pranë organeve shtetërore dhe pér pagimin e tatimit (në burim) mbi dividëndin brenda afateve ligjore.

NENI 24

Eksperti kontabël i jashtëm

Pasqyrat financiare të shoqërisë auditohen të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i jashtëm.

KREU V

Dispozita të fundit

NENI 25

Llogaria e ortakut

Ortakët, për nevoja likuiditeti të shoqërisë, mund të derdhin shuma parash në arkën e shoqërisë. Kjo hua e orfakut kundrejt shoqërisë nuk prodhon interesa, përveç nëse parashikohet ndryshe. Ortaku mund të kërkojë në çdo çast rimbursimin e huasë kundrejt një njoftimi 1-mujor, përveç nëse parashikohet ndryshe.

Ortaku nuk mund të marrë hua nga shoqëria. Çdo përcaktim tjetër eshtë i pavlefshëm.

NENI 26

Ligji rregullues dhe juridiksioni

Ky Statut rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Çdo mosmarrëveshje apo pretendim që mund të lindë në lidhje me interpretimin e këtij Statuti, do t'i nënshtrohet për zgjidhje gjyqësore Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ku ndodhet selia e Shoqërisë.

NENI 27

Regjistri Tregtar

Statuti depozitohet në Regjistrin Tregtar.

NENI 28

Gjuha

Ky Statut nënshkruhet në 2 (dy) kopje të njëjtë, në shqip, me fuqi të njëjtë.

ORTAKET THEMELUES

Ky statut u nenshkrua në Shkodër më 13.01.2021

Ortaku i vetëm

ARIZBEQ BASHKAI 
(Emr Mbiemr)